



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivered	04.08.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDNST/UC	5511/2023		1/6



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.823/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehemti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, si dhe Kaltrina Avdullahi Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.823/2023 të datës 08.06.2023 dhe ankesën me numër A.nr.812/2023 të datës 05.06.2023, të parashtruar nga ankuesi " " ne adresë: Rr" " , Komuna e Fushë Kosovës, të bashkuar sipas Vendimit me numër VK/2023 të datës 19.07.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në një ankesë me numër A.nr.823/2023, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr.837/2023 i datës 06.06.2023 i Sekretarës së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa lënda kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje* tek Drejtori i Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migracion në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

II. OBLIGOHET Drejtori i Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migracion në kuadër të Qendrës për Mbajtjen e të Huajve, që të bëjë zbatimin e këtij Vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij duke bërë rishqyrtimin e kërkesës së datës 01.12.2022, 04.01.2023, 02.02.2023 dhe kërkesën e datës 27.03.2023 të parashtruara nga ankuesi

III. OBLIGOHET Sekretarja e Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme që të Kujdeset për zbatimin e këtij Vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

## A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_, i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme në pozitën e punës “Udhëheqës i Qendrës për Mbjajtjen e të Huajve” në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion, më datë 01.12.2022, 04.01.2023 si dhe 02.02.2023 ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Burimeve Njërëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme për kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të punës., mirepo i njëjti nuk ka marre përgjigje, andaj me date 14.03.2023 ka parashtruar ankese ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të punës sipas kërkesave të datës 01.12.2022, 04.01.2023 si dhe 02.02.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me date 16.05.2023 ka nxjerr Vendimin me numër A.nr. 496/2023 me të cilin e detyruar Menaxherin e Burimeve Njërëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme të nxjerr akt administrativ lidhur me shqyrtimin e kërkeses se dates 04.01.2023 te parashtruar nga aankuesi.

Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme ne zbatim të Vendimit me numër A.nr. 496/2023 te dates 16.05.2023 te Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 06.06.2023 ka nxjerr Vendim me numër Nr. 837/2023 me të cilin e ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin se i njëjti nuk ka pasur kërkesë nga institucioni për të punuar jashtë orarit të rregullt të punës.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.837/2023 të datës 06.06.2023, të Sekretarës së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 08.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4629/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të punës sipas kërkesave të datës 01.12.2022, 04.01.2023 si dhe 02.02.2023.

Po ashtu ankuesi 27.03.2023 ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Burimeve Njërëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme për kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të punës, por nuk ka marre përgjigje, andaj me date 05.06.2023 ka parashtruar ankese ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të punës sipas kërkeses së datës 27.03.2023 gjithashtu edhe kompensimin e pagesës së parkingut pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës-QKUK.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës më datë 13.06.2023 ka pranuar përgjigjen nga Ministria e Punëve të Brendshme së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Pas vlerësimit të kërkesës së datës 19.07.2023 të Kryetarës së Kolegjit, Kryetari i Këshillit ka vlerësuar se ankuesi ka parashtruar dy ankesat me objekt të çështjes së njëjtë të cilat bazohen në bazë juridike dhe gjendje faktike të njëjtë, andaj ka marrë Vendim me numër VK/2023 me të cilin ka bashkuar lëndët si në preambulën e këtij Vendimi në një procedurë të cilat kanë marrë numrin e fundit të ankesës A.nr.823/2023.

Me Vendimin me numër të protokollit 5316/2023 të datës 20.07.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.823/2023 të datës 08.06.2023 edhe dhjetë (10) ditë pune.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesat për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës më datë 13.06.2023 ka pranuar përgjigjen nga Ministria e Punëve të Brendshme së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa me numër protokollit 4623/2023 e datës 08.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër Nr.837/2023 i datës 06.06.2023; Vendimi me numër A.nr.496/2023 i datës 15.05.2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë me numër 2605/2023 e datës 14.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë me numër Nr.203 e datës 01.12.2023; Kërkesë e datës Nr.12/13 e datës 04.01.2023; Rregullore (MPB) Nr.04/2018 pr Funkionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve; Lista e kujdestarisë për muajin tetor për QMH; E-mail i datës 03.10.2023; Raport për muajin Dhjetor 2022; Orari i kujdestarisë në QMH; Raport për muajin Janar 2023; Kërkesë me numër 12/2019 e datës 01.10.2019; E-mail i datës 02.03.2023; E-mail i datës 24.01.2023; E-mail i datës 23.01.2023; E-mail i datës 08.12.2022; E-mail i datës 02.12.2022; Raport ditor i datës 24.11.2022; E-mail i datës 18.11.2022; E-mail i datës 29.08.2022; E-mail i datës 05.08.2022; E-mail i datës 04.08.2022; E-mail i datës 07.07.2022; 06.07.2023; E-mail i datës 01.12.2022; E-mail i datës 18.11.2022; E-mail i datës 24.11.2022; Kërkesë e datës 01.12.2022; Dosja e punës jashtë orarit e datës 01.12.2022; E-mail i datës 25.11.2022; Raporti periodik i evidencës së hyrjeve dhe daljeve për periudhën 01.11.2022-30.11.2022; Listë e vijueshmërisë e datës 30.11.2022; Kërkesë e datës 04.01.2023; Dosja e punës jashtë orarit 04.01.2023; Raport i prezencës në punë për periudhën 01.12.2022 deri më 31.12.2022; Listë e vijueshmërisë e date datës 31.12.2022; Raport periodik i evidencës së hyrjeve dhe daljeve për periudhën 01.12.2022 deri më 31.12.2022; E-mail i datës 20.02.2023; E-mail i datës 28.06.2022; Kërkesë e datës 02.02.2023; Dosja e punës jashtë orarit e datës 02.02.2023; Raport i prezencës në punë i datës 01.01.2023 deri më 31.01.2023; Raport nga HRIMS i datës 01.01.2023; E-mail i datës 26.01.2023; Vendim për bashkim të procedurës i datës 19.07.2023; Ankesë me numër protokollit 2605/2023 e datës 14.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 3056/2023 e datës 28.03.2023; Përgjigje në ankesë e datës 17.05.2023; Ndryshim i Aktit të Emërimit me numër Nr.979 i datës 14.12.2018; Listë e pagave për muajin dhjetor 2022; Listë e pagave për muajin janar 2023; Listë e pagave për muajin shkurt 2023; Ankesë me numër protokollit 4586/2023 e datës 05.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 27.03.2023; E-mail i datës 27.03.2023; Formulari për punë jashtë orarit të rregullt të punës i datës 20.03.2023; Tiket e datës 24.03.2023 ora 18:43:55 e QKUK; Raport nga HRIMS i datës 20.03.2023; Kërkesë e datës 13.03.2023; Formular për punën jashtë orarit i datës 06.03.2023; E-mail i datës 07.03.2023; Raport nga HRIMS i datës 01.03.2023 deri më 10.03.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 07.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 13.06.2023; Listë e pagave për muajin Prill 2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se lënda kthehet në *ri-shqyrtim dhe rivendosje tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, sepse:*

Ankuesi në ankesën e datës 05.06.2023 dhe 08.06.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.837/2023 të datës 06.06.2023 në lidhje me për kompensimin e orëve shtesë, konkretisht kërkesën e datës 04.01.2023 e cila është refuzuar nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe kundër mos kthimit të përgjigjes lidhur me kërkesat e datës 01.12.2022 , 02.02.2023 dhe 27.03.2023 për heshtje administrative dhe mos kompensimin e pagesës së parkingut të Qendrës Klinike Universitare-QKUK, pretendon se Vendimi me numër Nr.837/2023 i datës 06.06.2023 i Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme është në kundërshtim me Vendimin me numër A.nr.496/2023 të datës 16.05.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyes Civil të Kosovës, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe Ligjin Nr.08/L-196 për Paga në Sektorin Publik. Andaj mbi këtë bazë i njëjti kërkon nga Këshilli që të aprovoj si të bazuar ankesën dhe të obligoj Drejtorin e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion, Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Divizionin e Burimeve Njerëzore që të bëjë kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të punës.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të punës, sipas kërkesës së datës 01.12.2022 , 04.01.2023, 02.02.2023 dhe 27.03.2023 gjithashtu edhe për kompensimin e pagesës së parkingut të QKUK, i 'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 19 i cili përcakton se: "*Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*", si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, pasi faktikisht i njëjti ka qenë në fuqi në kohën kur janë mbajtur orët shtesë dhe kohën kur janë parashtruar kërkesat për kompensimin e orëve shtesë përkatësisht nenit 4 paragrafi 1, i cili përcakton se: "*Paga e nëpunësve civilë përbëhet nga paga bazë dhe nga shtesat mbi pagën bazë, të përcaktuara me këtë ligj*", ndërsa referuar nenit 14 të këtij ligji, janë përcaktuar edhe llojet e shtesave që mund të aplikohen ndaj nëpunësve civil, ku përcaktohet se: "*Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut*", ndërsa në mënyrë të hollësishme më akt nënligjor janë përcaktuar edhe mënyrat e realizimit të shtesave që derivojnë nga ky ligj, si rrjedhojë Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht neni 4 ka paraparë llojet e shtesave, ndërsa neni 5 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar llojet e kompensimeve ndaj nëpunësve civil, po ashtu neni 10 dhe 11 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kushtet dhe planifikimin e buxhetit për pagesën e shtesave dhe kompensimeve respektivisht kompensimi për punë jashtë orarit. Kolegji po ashtu iu referua edhe Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i cili ka hy ne fuqi me date 05.02.2023 përkatësisht neni 13 i cili përcakton se: "*Paga e nëpunësve/it civile përbëhet nga paga bazë, shtesat dhe kompensimet, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji.*", ndërsa referuar nenit 35 të këtij ligji, janë përcaktuar edhe llojet e kompensimeve që mund të aplikohen ndaj nëpunësve civil, ku përcaktohet se: "*1.1. kompensimi për kujdestari; 1.2. kompensimi për punë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës; 1.3. kompensimi për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare; 1.4. kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e përfaqësimit; 1.5. kompensimi për funksionin shtesë; 1.6. kompensimi për anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; dhe 1.7. kompensimi për stafin tjetër të administratës që punojnë jashtë vendit*", ndërsa neni 36 paragrafi 2 i këtij ligji ka rregulluar përqindjen e kompensimeve të tilla ku përcaktohet se: "*2. Kompensimi sipas paragrafit 1. të këtij neni paguhet në përqindje të pagës bazë sipas ligjit përkatës për punë, si më poshtë: 2.1. 20 % në orë për kujdestari; 2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës; 2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit; 2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 2.5. 50 % në orë për punë gjatë fundjavës*", rrjedhimisht edhe Rregullorja (QRK) Nr. 07/2023 për Kompensimin për Kujdestari,

Punën Gjatë Natës dhe Punën Jashtë Orarit të Punës ka përcaktuar mënyrat e kompensimeve të cekura si më lartë, duke përcaktuar edhe hapat procedural për miratimin e këtyre kompensimeve konkretisht neni 7 paragrafi 1 dhe 2 i kësaj rregulloreje kanë përcaktuar se: "1. Zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, kanë të drejtë të kompensohen për punën jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës. 2. Puna jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës mund të realizohet vetëm kur i punësuari ka pëlqim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ka autorizim paraprak të arsyetuar nga udhëheqësi më i lartë i institucionit". Po ashtu lidhur me këtë çështje Kolegji i Këshillit i'u referua Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë e cila në nenin 8 ka përcaktuar punën jashtë orarit dhe mënyrat e kompensimit të tyre, ndërsa neni 56 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka përcaktuar pagën shtesë për kujdestari, punë gjatë natës, punë jashtë orarit, punë gjatë ditëve të festave dhe punë gjatë fundjavës si dhe shumatat në bazë të të cilave mund të bëhet ky kompensim. Gjithashtu Kolegji lidhur me këtë çështje juridike-administrative, i'u referua edhe Aktvendimit për Pranueshmëri në rastin KI37/22 të datës 26.09.2022 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të parashtruar nga Korporata Energjetike e Kosovës SH.A lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 443/21 të datës 10 janar 2022, ku është vendosur për objektin e njëjtë si në rastin e ankuesit si dhe Rregullores (MPB) Nr.04/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve përkatësisht nenin 7 paragrafi 1 dhe 2 me të cilin përcaktohet koha e hapjes së Qendrës dhe pranimi i të huajve si në vijim: 1. "Qendra është e hapur në ditë pune nga ora 8:00 deri në ora 16:00. Jashtë këtyre orëve, gjatë fundjavës dhe festave zyrtare, Qendra është e mbyllur" 2. "Përyjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, të huajt të cilët janë ndaluar nga Policia e Kosovës, mund të pranohen në çdo kohë në Qendër, 24 orë, 7 ditë në javë dhe mund të largohen në çdo kohë nga Qendra pas pranimi të vendimit nga DMH-ja, nga zyrtari kujdestar i Qendrës, i cili duhet të dalë në Qendër për pranimin, ose largimin e të huajit".

Rrjedhimisht duke ju referuar dispozitave të lartcekura, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi pranë organit të punësimit ka sjellë dëshmi se ka punuar jashtë orarit të rregullt të punës respektivisht çdo here ankuesi përmes e-malit zyrtar e ka njoftuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë për akomodimin apo largimin e të huajve në Qendrën e Mbajtjes se të Huajve si dhe ka kërkuar autorizim për ta lejuar të punoj jashtë orarit të rregullt të punës, po ashtu i njëjti ka dërguar kërkesat për kompensimin e orëve shtesë në formë fizike dhe formularët me orët e plotësuar, por që asnjëherë nuk ka marr përgjigje nga ana e mbikëqyrësit të tij përveç ndaj kërkesës së datës 04.01.2023 e cila i është refuzuar dhe ndaj kërkesës së datës 13.03.2023 e cila i është aprovuar nga ana e Sekretares se Përgjithshme të MPB-së.

Kolegji i Këshillit, lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ankesë konkretisht, Vendimit me numër protokollit 837 të datës 06.06.2023 të Sekretares se Përgjithshme të MPB-së, konstaton se është i paqartë dhe kundërthënës dhe mbi këtë pikëpamje juridike Kolegji i Këshillit vlerëson se e njëjta nuk ka dhënë arsye të sakta dhe konkrete lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit, andaj në kuptim të dispozitave të nenit 52 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ky akt është i paligjshëm ngase nuk janë shqyrtuar në plotëni pretendimet e palës në kuptim të nenit 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe po ashtu gabimisht është zbatuar ligji material, ngase janë aplikuar dispozitat ligjore që nuk kanë qenë në fuqi në kohën kur ankuesi ka parashtruar kërkesën e tij. Nisur nga natyra juridike e ankesës dhe pretendimet në ankesë, Kolegji i Këshillit konstaton se lidhur me kërkesat e ankuesit duke marrë për bazë

dispozita ligjore të lartcekura është e domosdoshme që lënda kthehet në rishqyrtim dhe ri vendosje tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, me qëllim që i njëjti pas shqyrtimit të tyre të veprave konform dispozitave ligjore që kanë qenë dhe janë të aplikueshme për rastin konkret, dhe po ashtu mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë duhet të konstatojë faktin se Qendra për Mbajtjen e të Huajve a funksionon sipas orarit të rregullt të punës apo sipas kujdestarive dhe nëse funksionon me kujdestari atëherë të konstatojë se a ka qenë i përcaktuar orari i kujdestarive në kohën kur ankuesi po kërkon kompensimin, po ashtu duhet konstatuar fakti se me sa zyrtarë funksionon kjo Qendër dhe a ka pasur gjatë kësaj periudhe ndonjë zyrtar tjetër që ka punuar jashtë orarit të punës apo vetëm ankuesi, andaj ky i

fundit gjegjësisht Drejtori i Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migracion mbi bazën e konstatimit të gjendjes faktike dhe pikëpamjeve juridike të dhëna si në arsyetim të këtij vendimi të vendos në mënyrë meritore lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit respektivisht të shqyrtuarit të datës 01.12.2022, 04.01.2023, 02.02.2023 dhe 27.03.2023 të parashtruara nga ankuesi lidhur me kompensimin e orëve shtesë jashtë orarit të punës dhe për kompensimin e pagesës së parkingut të QKUK-së dhe të vendose në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe lëndën ta procedoj me tutje tek Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit.

Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

*Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.823/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Drejtorit të Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migracion-MPB;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK- së;